11. Treguesit mjedisor të turizmit

Turizmi ka rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik dhe atë kulturor të një vendi. Por zhvillimi i tij ka ndikim negativ në mjedis e ne veçanti në ekosistemet natyrore si rezultat i hedhjes së pakontrolluar e mbeturinave, dëmtimit të resurseve natyrore dhe biodiversitetit. Me qëllim të zvogëlimit të këtij ndikimi krahas aspektit ekonomik, turizmi duhet ti kushtojë vëmendje edhe mbrojtjes së mjedisit, andaj si jë formë e avancuar e turizmit sot njihet ekoturizmi apo turizmi i qëndrueshëm.

11.1. Vizitat e turistëve

Emri i treguesit	**Vizitat e turistëve**
Kodi i treguesit	TU01
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i forcave shtytëse
Përshkrimi i treguesit	Përmes këtij treguesi prezantohet dinamika e vizitave të turistëve (vendor dhe të jashtëm), në total dhe sipas vendit të prejardhjes, sipas komunave, sipas vendeve turistike, sipas vendeve ku janë vendosur dhe tipave të objekteve ku janë vendosur. Me termin vizitorë, nënkuptohet numri i turistëve që qëndrojnë një apo më shumë natë në objektet përkatëse (hoteliere apo tjera) për periudhën e caktuar kohore të monitoruar. Përmes këtij treguesi prezantohen të dhënat për densitetin e qarkullimit turistik dhe tregohet presioni në zonat turistike duke u bazuar në këta parametra: • Numri i turistëve për km² • Numri i turistëve për banorë • Numri i turistëve për muaj • Numri i turistëve sipas regjioneve zonave
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Metodologjia e mbledhjes se të dhënave statistikore në sektorin e turizmit që realizohet nga institucioni nacional përgjegjës për statistika duhet të jetë e bazuar në udhëzues për statistikat e turizmit sipas Bashkimit Evropian apo Organizatës Botërore për Tregti.
Njësia matëse	• Numri i turistëve shprehet në mijë për km², për kokë të banorit, për muaj dhe për regjion • Pjesëmarrja e numrit të turistëve sipas komunave, vendeve nga vijnë, llojet e objekteve për qëndrim në numrin total të turistëve shprehet në përqindje (%).
Burimi i të dhënave	Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Divizioni i Turizmit.
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Në Kosovë nga viti në vit ka pasur rritje të numrit të turistëve të jashtëm që kanë vizituar vendin, por njëkohësisht është rritur edhe numri i turistëve të brendshëm. Nëse e analizojmë numrin e turistëve të huaj në Kosovë që nga vitit 2010 e deri në vitin 2019, do të vërejmë se ka një rritje progresive të numrit te turistëve dhe netëve të qëndrimit të tyre. Në vitin 2019, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës janë regjistruar rreth 177.358 turistë të jashtëm. Sa i përket vizitoreve vendor, numri i turistëve ishte 109,725 turistë. Krahasuar me vitin paraprak kishte një rënie të lehtë të numrit të turistëve të jashtëm dhe vendor. Ndërsa krahasuar me vitin 2010, numri i turistëve të jashtëm dhe vendor, është pesëfishuar (figura 1).



Figura 1. Numri i vizitorëve të jashtëm dhe vendor 2010 – 2019

Sa i përket pjesëmarrjes së turistëve sipas regjioneve prinë Prishtina me 59% të numrit të përgjithshëm të vizitorëve, Prizreni me 15% të vizitorëve dhe Peja me 13% të numrit të përgjithshëm të vizitorëve (figura 2).



Figura 2: Vizitorët sipas regjioneve (%)

Sipas të dhënave të vitit 2019, Kosova në baza vjetore ka rreth 26 turistë për 1km^2, dhe rreth 0.28 vizitorë për kokë banori. Mesatarja mujore e vizitorëve është rreth 40.866.
Sa i përket vendeve prej nga vijnë, numri më i madh ti turistëve të jashtëm vijnë nga vendet e regjionit (Shqipëria 26%, Maqedonia e Veriut 22% dhe Serbia 26%), kurse nga vendet tjera jashtë regjionit numri më i madh i vizitorëve vije nga Gjermani 5% dhe Zvicra 4% (tabela 1).

Tabela 1: Prejardhja e turistëve të jashtëm që vizitojnë Kosovën

Vendi	Nr i turistëve	%
Austria	57,414	1
Belgjika	33,692	1
Britania e Madhe	58,235	1
Franca	32,165	1
Gjermania	229,486	5
Italia	29,203	1
Kroacia	32,504	1
Mali i Zi	154,715	3
Maqedonia	1,086,626	22
Serbia	1,399,829	28
SHBA	48,006	1
Shqipëria	1,272,024	26
Turqia	75,345	2
Zvicra	207,906	4
Të tjera	245185	3

11.2. Netët e qëndrimit të turistëve

Emri i treguesit	**Netët e qëndrimit të turistëve**
Kodi i treguesit	TU02
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i forcave shtytëse
Përshkrimi i treguesit	Përmes këtij treguesi prezantohet trendi i netëve të qëndrimit të turistëve (vendor dhe të jashtëm), në total dhe sipas vendit të prejardhjes, sipas komunave, sipas vendeve turistike, sipas vendeve ku janë vendosur dhe tipave të objekteve ku janë vendosur. Përmes këtij treguesi prezantohen të dhënat për densitetin e qarkullimit turistik dhe tregohet presioni në zonat turistike dhe ndikimet sezonale duke u bazuar në këta parametra: • Numri i turistëve për km^2 • Numri i turistëve për banorë • Numri i turistëve për muaj • Numri i turistëve sipas regjioneve zonave
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Metodologjia e mbledhjes se të dhënave statistikore në sektorin e turizmit që realizohet nga institucioni nacional përgjegjës për statistika duhet të jetë e bazuar në udhëzues për statistikat e turizmit sipas Bashkimit Evropian apo Organizatës Botërore për Tregti.
Njësia matëse	• Numri i netëve të qëndrimit te turistëve shprehet në mijë

	• Pjesëmarrja e numrit të netëve të qëndrimit të turistëve sipas komunave, vendeve nga vijnë, llojet e objekteve për qëndrim në numrin total të turistëve shprehet në përqindje (%) • Numrit të netëve të qëndrimit të turistëve sipas llojeve të vendeve turistike shprehet në mijë ose si përqindje (%), e pjesëmarrjes së secilit vend turistik në numrin total të turistëve.
Burimi i të dhënave	Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Divizioni i Turizmit
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Sikurse për numrin e turistëve në Kosovë nga viti në vit ka pasur rritje edhe të netëve të qëndrimit për të dy grupet e turistëve të jashtëm dhe vendor. Nëse analizojmë netët e qëndrimit të turistëve të huaj dhe vendor, që nga vitit 2010 e deri në vitin 2019, ka një rritje progresive të numrit të netëve të qëndrimit të tyre. Në vitin 2019, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës janë regjistruar rreth 321.581 natë qëndrimi të turistëve të jashtëm, ndërsa netët e qëndrimit të vizitorëve të vendor ishin 168,821 natë. Krahasuar me vitin paraprak kishte një ngritje të lehtë të netëve të qëndrimit të turistëve të jashtëm dhe vendor, ndërsa krahasuar me vitin 2010, numri i turistëve të jashtëm dhe vendor, është pesëfishuar (figura 3).



Figura 3:. Numri i netëve të qëndrimit të vizitorëve të jashtëm dhe vendor 2010 – 2019

Sa i përket netëve të qëndrimit të turistëve sipas regjioneve, sikurse edhe për numrin e turistëve regjioni Prishtinën, Prizrenit dhe Pejës janë regjionet me % me të madhe të netëve të qëndrimit për turistë vendor dhe të huaj, ndërsa që edhe prejardhja e turisteve sipas netëve të qëndrimin është e njëjtë sikur se vizitat e tyre (figura 3 dhe tabela 1).

11.3. Intensiteti i turizmit

Emri i treguesit	**Intensiteti i turizmit (Numri i shtretërve dhe shkalla e shfrytëzimit të këtij kapaciteti)**
Kodi i treguesit	TU03
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i forcave shtytëse
Përshkrimi i treguesit	Përmes këtij treguesi prezantohet numri i shtretërve dhe disponueshmëria e tyre sipas vendit të prejardhjes, sipas komunave, regjioneve dhe llojeve të objekteve për vendosje/pushim, si dhe shkalla e shfrytëzimit të tyre.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Metodologjia e mbledhjes se të dhënave statistikore në sektorin e turizmit që realizohet nga institucioni nacional përgjegjës për statistika duhet të jetë e bazuar në udhëzues për statistikat e turizmit sipas Bashkimit Evropian apo Organizatës Botërore për Tregti. Po ashtu llogaritja mundë të bëhet edhe sipas metodologjisë së Agjencisë Evropiane të Mjedisit për treguesin e Intensitetit të turizmit.
Njësia matëse	• Numri i shtretërve për km^2 • Numri i shtretërve për banorë • Raporti në mes të numrit të netëve të qëndrimit te turistëve dhe shtretërve në dispozicion për periudhën e monitorimit. • Disponueshmëria e kapaciteteve për vendosjen e turistëve shprehet në përqindje %.
Burimi i të dhënave	Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Divizioni i Turizmit
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave, Kosova ka mbi 11101 shtretër për akomodim të vizitorëve, me 7077 dhoma të cilat janë të shpërndara në 466 njësi akomoduese. Numri më i madh i njësive akomoduese i takon hoteleve me 214 njësi dhe moteleve me 177 njësi (tabela 2).

Tabela 2: Kapacitetet e akomodimit të turistëve në Kosovë sipas llojit të akomodimit[1]

	Njësi	**Dhoma**	**Shtretër**
Hotele	214	4457	7195
Motele	177	2132	2836
Bujtina	10	46	99
Hostele	9	43	171
Apartamente	15	25	32
Bungallo	41	374	768
Gjithsej	466	7077	11101

[1] *Statistikat e hotelerisë, ASK 2019*

Prishtina është regjioni që ka numrin me të madh të njësive, shtretërve dhe dhomave në dispozicion për akomodimin e turistëve. Pas Prishtinës, vijnë Prizreni dhe Peja me kapacitetet në dispozicion për akomodimin e turistëve (figura 61). Sipas përllogaritjeve Kosova ka rreth 1 shtretër për 1km², dhe 0.006 shtretër për kokë banori.



Figura 4: Kapacitetet e akomodimit të turistëve në Kosovë sipas regjionit dhe llojit

11.4. Numri i turistëve në Parqe Kombëtare

Emri i treguesit	**Numri i turistëve (vizitorëve) në Parqe Kombëtare**
Kodi i treguesit	TU04
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i forcave shtytëse
Përshkrimi i treguesit	Përmes këtij treguesi prezantohet numri i përgjithshëm i turistëve në Parqet Kombëtare, Numri i vizitorëve sipas Parqeve Kombëtare për vit/sezon dhe numri i vizitorëve për km² të parkut.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Metodologjia e mbledhjes se të dhënave statistikore në sektorin e turizmit që realizohet nga institucioni nacional përgjegjës për statistika duhet të jetë e bazuar në udhëzues për statistikat e turizmit sipas Bashkimit Evropian apo Organizatës Botërore për Tregti.
Njësia matëse	• Numri i vizitorëve në Parqe Kombëtare • Numri i vizitorëve për km² të Parqeve Kombëtare
Burimi i të dhënave	Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Divizioni i Turizmit, Drejtoritë e Parqeve Kombëtare
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Parqet Kombëtare paraqesin një ndër destinacionet me të rëndësishme turistike të një vendi. Edhe Parqet Kombëtare të Kosovës “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”, janë ndër zonat më atraktive turistike dhe destinacione të preferuara për vizitorë të jashtëm dhe të brendshëm.

Në mungesë të zyrave të informimit në Parqe Kombëtare, ende nuk ka të dhëna të plota për numrin e përgjithshëm të turistëve që kanë vizituar Parqet Kombëtare gjatë një viti apo gjatë një sezone. Megjithëkëtë mundë të bëhet një vlerësim i përafërt nëse i marrim në konsideratë të dhënat për numrin e përgjithshëm të vizitorëve të jashtëm dhe vendorë që kanë vizituar regjionin e Pejës dhe atë të Prizrenin, duke aluduar që të njëjtit turistë kanë vizituar edhe Parqet tona Kombëtare që shtihen në këtë zonë, përkatësisht PK Bjeshkët e Nemuna dhe PK Sharri. Bazuar në këto vlerësime numri vjetor i turistëve që kanë vizituar Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" në vitin 2019 ishte rreth 22 mijë, ndërsa i atyre që kanë vizituar Parkun Kombëtarë "Sharri", ishte rreth 16 mijë. Nga ky vlerësim po ashtu mundë të vërehet që kishte një rënie të numrit të turistëve që kanë vizituar Parqet Kombëtare në vitin 2019 krahasuar me vitin paraprak (figura 5). Numri i vizitorëve për km² në Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" për vitin 2019, ishte rreth 36 vizitorë/1 km², ndërsa numri i vizitorëve për km² në Parkun Kombëtarë "Sharri" në vitin 2019 ishte rreth 31 vizitorë/1 km².



Figura 5: Numri i vizitorëve në Parqe Kombëtare